

Data 23/09/2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit: “NDËRTIMI I QENDRËS MULTIFUNKSIONALE KAMPUSI RINOR PRANË DROFPP nr.4 TIRANË”

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 45211350-7, Punime ndërtimi për ndërtesa multifunksionale.

Vlera e fondit limit: 222,179,998.30 (dyqind e njëzet e dy milion e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë presje tridhjetë) **lekë pa TVSH**

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 18 (tetëmbëdhjetë) muaj kalendarikë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerje të Përqëndruara sh.a.**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

Sipas parashikimeve ligjore për procedurat të cilat realizohen nga Organi Qëndror Blerës, Specifikimet Teknike, Projekti etj. dhe llogaritja e Fondit Limit përcillen nga Autoriteti Kontraktor i cili kërkon realizimin e punimeve.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas Shtojcës 7 të DST

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2021, 2022, 2023) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

Shëmin: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik (e ndryshuar)”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr.10091 date 05.03.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar).

2. Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2021, 2022, 2023) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e kontratës. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2/a dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar). Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: **111,089,999** (njëqind e njëmbëdhjetë milion e tetëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: **444,359,996.6** (katërqind e dyzet e katërmilion e treqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë presje gjashtë) lekë pa TVSH.

Plotësimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

1.2 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.

Shënim : *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim;
 - Fatura tatimore përkatëse të deklaruara në organet tatimore.

Shënim : *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- 1.3** Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontraten e Bashkimit të operatoreve ekonomik si dhe prokurën e posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit.
- 1.4** Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që:

Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllorarit të kontratës që prokurohet konkretisht: **111,089,999** (njëqind e njëmbëdhjetë milion e tetëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: **444,359,996.6** (katërqind e dyzet e katërmilion e treqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë presje gjashtë) lekë pa TVSH. Plotesimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e ben oferten të kualifikueshme. Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Gjithashtu referuar VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, citohet se: “Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes

së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.” AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (1.2-1.4), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) ku qartazi përcaktohet se: **”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.**

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), ku përcaktohet se: **“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”**

AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave 1.3 dhe 1.4, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Sqarojmë se nga praktika, gjatë fazes së vlerësimit të ofertave, AK ka hasur vështirësi në vlerësimin në mënyrë sa me të drejtë të përvojës së ngjashme, pasi jo të gjitha institucionet shtetërore apo private leshojnë Formularin e Vlerësimit sipas formatit zyrtar (ku përcaktohet ndarja e përqindjeve). Në kuader të vlerësimit të ofertave në mënyrë sa me të drejtë, duhet që në rastet e BOE apo Nenkontraktim, vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontrates së bashkëpunimit; me marrëveshjen e nenkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nenkontraktimit leshuar nga Institucioni. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qene Nënkontraktor. Ky

dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk mund të sjellë kufizim të pjesmarrjes së OE në tender as në mënyrë direkte dhe as në mënyrë indirekte.

Gjykojmë që kërkesa e mësipërme nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore që parashikon legjislacioni i prokurimit publik.

Gjithashtu vendos në kushte të barabarta dhe u jep mundësi të gjithë OE Ofertues edhe në ato rastet kur Formularët e Vlerësimit mund të jenë të paplotesuara sipas standartit.

AK ka kërkuar këto dokumenta në përputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), ku ndër të tjera përcaktohet se: ***Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.***

2.3.2 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktura dhe Energji, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

- **NP-1A** Punime gërmimi në tokë
- **NP-2E** Ndertime civile dhe industriale
- **NP-7 A.** Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje.
- **NP-12A** Punime të inxhinierisë së mjedisit

Për punimet speciale të ndërtimit :

- **NS-1A** Punime për prishjen e ndërtimeve.
- **NS-2A** Impiante hidro-termosantare dhe mirëmbajtja e tyre.
- **NS-3A** Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues)
- **N.S-4 B** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.
- **NS-9A** Punime Strukturore Speciale
- **NS-12 B** Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit.
- **NS- 14 B** Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.
- **N.S – 18 A** Punime topogjeodezike

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktura dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a,

të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), si dhe mbështetur në Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve.

Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive
NP 1 A	Punime gërmimi ne toke	-Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet -Gërmim dheu me ekskavator zingjir 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi > 2 m, prani uji ~ 2m, kategoria III, me shk ne mjet -Gërmim dheu me ekskavator goma 0.15 m ³ , ne themele, toke zak, kategoria III, me shkarkim ne toke etj.	A (0- 20 milionë lekë)
NP 2 E	Ndertime civile e industriale	F.V dyer druri Dyer d/alumini me mbushje element d/a. F.V dyer metalike llamarine Vetrato xhami i temperuar F V dritare d/alumini plastike me dopio xham Heqje ulluk shkarkimi plastik vertikal Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 1 k katrama Hidroizolim me dy shtresa astar me baze cemento. Pergatitur nga dy komponente A+B Shtrese termoizoluese me polisterol t=10 cm Shtrese termoizoluese me polisterol t=10 cm Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat Ø 100 Kasete shkarkimi me llamarine xingat Veshje kornize llamarine xingat Mbulim çatie me panele sanduich Skarifikim shtrese asfalti ekzistues me makineri Shtrese stabilizant t=15cm Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri Cilindrim shtrese çakelli t=15cm, me rul Shtrese zhavor lumi t=10cm Suva e zakonshme fasade mur tulle ~ 8m Plintuse pllake grez Veshje me pllake majolike Veshje tavani me kartonxhes Tavani varur me pllaka gipsi 60x60cm Patinim tavani allçi (stuko) Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25 Patinim muri allçi (stuko) Veshje fasade me xham struktural i pathyeshem Veshje fasade me alukobonde Veshje fasade me polisterol t=5cm + rrjete + suva. F V hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm F V hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm Pllake themeli, trare e bazamente b/a C 25/30 Breza b/a monolit C 16/20 Mure b/a t = 11-20cm h ~ 4m C 16/20	E (201-400 milionë lekë)

		<p>Soleta te plota b/a C 20/25 t = 10 cm, h ~ 4m Mure b/a t = 21-30cm, h ~ 4m C 20/25 F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm F V hekur betoni periodik Ø > 12 mm F V konstruksione metalike te thjeshta Mur me tulla me 6 vrime, t=12cm h~3m, ll perz M 15 Ndetim muri me gips t=10cm me dy shtresa kunder lageshtires Veshje muri me MDF Boje hidroplastike cilesi e larte F.V zgara dekorativa hekuri mesatare etj.</p>	
NP-7 A	Ujësjetllës, ,kanalizime, vepra kullimi e vaditje.	<p>F.V. Tub kanalizimi pvc Ø 200 FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~25mm, Pn 25 FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~32mm, Pn 16 FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=40mm, Pn 16 FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=90mm, t = 6.7 mm, Pn 10 Puse kontrolli 1x1x1.5m F.V Tuba shkarkimi + rakorderi PP Ø 160 F.V Tuba shkarkimi + rakorderi PP Ø 125 F.V Tuba shkarkimi + rakorderi PP Ø 110 F.V Tuba shkarkimi + rakorderiPP Ø 75 F.V Tuba shkarkimi + rakorderi PP Ø 50 F.V.Pilete dysHEMEJE d50 dopio sifon F.V.Tubo PE - HD Ø63, PN10 + rakorderi F.V. Saracineske nentokesore me aks te gjate dhe puseta gize komplet per lidhjen e furnizimit me uje nga rrjeti urban F.V Puseta e lidhje me ujesjellesi (60 x 60) cm, me kapak gize Ø 60 cm, klasa C250 F.V.Tubo PE - HD Ø75, PN10 + rakorderi F.V. Pilete tarrace d110 F.V. Tubo korrogato SN 8 d160 F.V. Tubo korrogato SN 8 d200 F.V. Puseta betoni (60 x 60) cm, me kapak gize Ø 60 cm, klasa C250 F.V. Tubo korrogato SN 8 d250 F.V. Tubo korrogato SN 8 d315 F.V. Puseta betoni (60 x 60) cm, me kapak gize grile 60x40 cm, klasa C250 F.V. Tubo PE-HD me elektrofuzion PN 16 Ø 90x8.2 dhe rakorderi F.V. Tubo PE-HD me elektrofuzion PN 16 Ø 110x10 dhe rakorderi etj.</p>	A (0- 20 milionë lekë)
NP-12A	Punime të inxhinierisë së mjedisit	<p>Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km Hedhje,rrafshim,mbushje dheu me krah, kategoria III Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km Mbjellje bari ne skarpat F.V. Fidane Peme dekorative etj.</p>	A (0- 20 milionë lekë)
NS-1A	Punime per prishjen e ndertimeve .	<p>Prishje shtrese lluster-çimento dysHEMEJE Prishje shtresa betoni Prishje suvatim muri i brendshem Prishje mur tulle pa pastrim Prishje soleta b/a Prishje mure beton/arme Prishje kollona, trare b/a Prishje çatie ekzistuese me tjegulla etj.</p>	A (0- 20 milionë lekë)
NS-2A	Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre.	<p>Termoizolim tubi Ø 3/4" me armofleks (d28x9) Termoizolim tubi Ø 1 1/4" me armofleks (d42x9) F.V lavaman porcelani F.V WC allafrenga</p>	A (0-20 milionë lekë)

		<p>Termoizolim tubi Ø 1 1/2" me armofleks (d54x9) Termoizolim tubi Ø 2" me armofleks (d64x9) Termoizolim tubi Ø 2 1/2" me armofleks (d76x9) F.V tub xingato dhe rakorderi ~ 1 " F.V saracineska bronzi Ø 1 1/2 " = 40 mm FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=90mm, t = 6.7 mm, Pn 10 F V bolier 80 liter, uje te ngrohte F.V tub te zeze dhe rakorderi F.V.Tubo PEX/al, DN 12 (Ø16 X 2.0) mm, i termoizoluar δ= 6mm F.V.Tubo PEX/al, DN 15 (Ø20 X 2.2) mm, i termoizoluar δ= 6mm F.V. Brryla AL-PEX Ø16x1/2 F, me prese F.V. Bryla AL-PEX Ø20x1/2 F, me prese etj. F.V. Tubo çeliku i zi pategel Ø 1½" dhe rakorderi F.V. TABELE SINJALISTIKE. Hidrant zjarri i jashtem mbi toke F.V. TABELE SINJALISTIKE. Hidrant zjarri i brendshem F.V. TABELE SINJALISTIKE. Fikese me pluhur F.V. TABELE SINJALISTIKE. Fikese me CO2 F.V. TABELE SINJALIZIMI. Buton sinjalizimi F.V. TABELE SINJALISTIKE. Drejtim dalje emergjence F.V. TABELES SINJALISTIKE. Zbritje shkallësh F.V. TABELE SINJALISTIKE. NGJITJE SHKALLESH F.V. TABELE SINJALISTIKE. Rrezik tensioni i larte F.V TABELE SINJALISTIKE. Ndalim I shuarjes me uje F.V. Valvol nderperrese Ø 4" me flanaxha F.V Xhunto antivibruese DN 100 (Ø 4") me flanaxha F.V. Konik eksentrik me flanaxha F.V. Kolektore te MNZ F.V. Valvul flutur, DN 65, Pn 6 bar F.V Valvul flutur, DN 50, Pn 6 bar F.V. Valvul flutur, DN 32, Pn 6 bar F.V. Filter uji me rrjet DN 65, Pn 6 bar F.V. Xhunto antivibruese, DN 65 F.V. Reduktor presioni Ø 2 1/2 " F.V. Mates uji Ø 2 1/2 " F.V. Galexhent mekanik DN50 (Ø 2") F.V. Galexhant Elektrik etj.</p>	
NS-3A	Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues).	Ashensore (3 ndalesa/ dyer inoxi/ kabina inox forest, kendet inoxi) 630 kg Kapaciteti 8 Persona,	A (0-20 milionë lekë)
NS-4B	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndëruese.	<p>Suva e zakonshme fasade mur tulle ~ 8m Plintuse pllake grez Veshje me pllake majolike Veshje tavani me kartonxhes Tavan i varur me pllaka gipsi 60x60cm Patinim tavani allçi (stuko) Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25 Patinim muri allçi (stuko) Veshje fasade me xham struktural i pathyeshem Veshje fasade me alukobonde Veshje fasade me polisterol t=5cm + rrjete + suva. Boje hidroplastike cilesi e larte F.V zgara dekorativa hekuri mesatare Veshje e fasades me tulle terrakote + termoizolim Mur me tulla me 6 vrima, t=12cm h~3m, ll perz M 15 Ndetim muri me gips t=10cm me dy shtresa kunder lageshtires Veshje muri me MDF etj.</p>	B (21-50 milionë lekë)

NS-9A	Punime Strukturore Speciale	<p>Shpim me sonda ne toka te zakonshme Ø 800mm, thellesia (10-20m).</p> <p>Struktura monolite betoni me çakell C 30/37</p> <p>Struktura monolite betoni me çakell C 30/37</p> <p>F V hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm</p> <p>F V hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm</p>	A (0-20 milionë lekë)
NS-12B	Impiante teknologjik , termik dhe te kondicionimit	<p>F.V Kanale ajri prej paneli poliuretani i veshur me shtrese alumini nga te dyja anet per aplikime ne ambjente te brendshme.Piral HD Hydrotec antimikrobial me vete-pastrim, per predorim te brendshem. Spesori 20.5mm, densiteti 52 kg/m3, trashesia e aluminit 80/80 mikron, klasa e reagimit ndaj zjarrit</p> <p>F.V Kanale ajri - llamarine zingato $\delta = (1 \pm 0.6)$ mm, me fllanxa etj</p> <p>F.V. Valvol rrethore metalik per banjo Ø 100</p> <p>F.V Grile lineare 2D (70 x 20) cm</p> <p>F. V Tuba bakri Ø 15.88, $\delta = 1.0$ mm, per R410A,</p> <p>F.V. Armofleks, Ø50 mm</p> <p>F.V. Tuba bakri Ø 12.7, $\delta = 0.8$ mm, per R410A, dhe termoizolim me spesor $\delta = 10\sim 13$mm</p> <p>F.V. Tuba bakri Ø 9.52, $\delta = 0.8$ mm, per R410A, dhe termoizolim me spesor $\delta = 10\sim 13$mm</p> <p>F. V Tuba bakri Ø 6.35, $\delta = 0.8$ mm, per R410A, dhe termoizolim me spesor $\delta = 10\sim 13$mm</p> <p>F.V. Tuba bakri Ø 19.05, $\delta = 1.2$ mm, per R410A, dhe termoizolim me spesor $\delta = 10\sim 13$mm</p> <p>F. V Armofleks, Ø75mm</p> <p>F.V. Tuba bakri Ø 22.22, $\delta = 1.2$ mm, per R410A, dhe termoizolim me spesor $\delta = 10\sim 13$mm</p> <p>F.V. Tuba bakri Ø 25.4, $\delta = 1.2$ mm, per R410A, dhe termoizolim me spesor $\delta = 13\sim 15$mm</p> <p>F.V .Tuba bakri Ø 28.58, $\delta = 1.2$ mm, per R410A, dhe termoizolim me spesor $\delta = 13\sim 15$mm</p> <p>F.V. Tuba bakri Ø 31.8 $\delta = 1.2$ mm, per R410A, dhe termoizolim me spesor $\delta = 13\sim 15$mm</p> <p>F.V. Tuba bakri Ø 38.1 $\delta = 1.2$ mm, per R410A, dhe termoizolim me spesor $\delta = 13\sim 15$mm</p> <p>F.V Degezues Y (RNY 11)</p> <p>F.V. Degezues Y (RNY 12)</p> <p>F.V Degezues Y (RNY 21)</p> <p>F.V. Degezues Y (RNY 31)</p> <p>F.V Degezues Y (RNY 41)</p> <p>F.V Degezues Y (RNY M01)</p> <p>F.V. Degezues F</p> <p>F.V. Degezues F</p> <p>Montim Pajisje tip Dysheme/Tavan , kapaciteti ne ftohje / ngrohje 8.0 /9.0 kW, prurja e ajrit Vmax.= 1250 m³/h + termostat ambianti.</p> <p>Montim Pajisje tip Kasete me pompe kondense, kapaciteti ne ftohje / ngrohje 2.2/2.5 kW, prurja e ajrit Vmax.= 400 m³/h + termostat ambianti.</p> <p>Montim Pajisje tip Kasete me pompe kondense, kapaciteti ne ftohje / ngrohje 4.5 /5.0 kW, prurja e ajrit Vmax.=750 m³/h + termostat ambianti</p> <p>Montim Pajisje tip Kasete me pompe kondense, kapaciteti ne ftohje / ngrohje 6.3/7.1 kW, prurja e ajrit Vmax.=1150 m³/h + termostat ambianti</p> <p>Montim Pajisje tip Kasete me pompe kondense, kapaciteti ne ftohje / ngrohje 7.1/8.0 kW, prurja e ajrit Vmax.=1150 m³/h + termostat ambianti</p> <p>Montim Pajisje tip Kasete me pompe kondense, kapaciteti ne ftohje / ngrohje 8.0/9.0 kW, prurja e ajrit Vmax.=1250 m³/h + termostat ambianti</p>	B (21- 50 milionë lekë)

		<p>Montim Pajisje tip Kanalor me pompe kondense, kapaciteti ne ftohje / ngrohje 5.6 6.3 kW, prurja e ajrit Vmax.= 1000 m³/h + termostat ambienti</p> <p>Montim Pajisje tip Kanalor me pompe kondense, kapaciteti ne ftohje / ngrohje 7.1 /8.0 kW, prurja e ajrit Vmax.= 1250 m³/h + termostat ambienti</p> <p>MONTIM NJESI E JASHTEME KOMPRESOR INVERTER ME POMPE NXEHTESIE VRF PER KATIN +1</p> <p>Montim NJESI E JASHTEME KOMPRESOR INVERTER ME POMPE NXEHTESIE VRF PER KATIN 0°</p> <p>Montim NJESI E JASHTEME KOMPRESOR INVERTER ME POMPE NXEHTESIE VRF PER RIKUPERATORET E AJRIT</p> <p>MONTIM NJESI RIKUPERATORE AJRI Volumi i ajrit. 3920 m³/h Presioni statik i jashtem 200 Pa</p> <p>Montim. Kondicioner Mono Split DysHEME - Tavan Kapaciteti në ftohje: 12.1 kW Kapaciteti në ngrohje: 13.1 kW</p> <p>Montim Kondicioner Mono Split DysHEME - Tavan Kapaciteti në ftohje: 2.5 kW Kapaciteti në ngrohje:2.8 kW</p> <p>Montim Ventilator Centrifugal V.air. 16000 m³/h ~ ΔP 200 Pa Fel. 2.2 kW 3F~400V,50Hz</p> <p>Montim Ventilator Centrifugal V.air. 22000 m³/h ~ ΔP400Pa Fel. 5.5 kW 3F~400V,50Hz etj.</p>	
NS-14B	Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.	<p>F.V Kasete plastike KE me 54 modular (vende)</p> <p>F.V Kasete plastike KE me 12 modular (vende)</p> <p>F.V. Automat magneto-termik 380V,40A, 4P,Id=0.03A</p> <p>F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 32A, dl=0.03A</p> <p>F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 10A</p> <p>F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 16A</p> <p>F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 32A</p> <p>F.V Siguresa ~ 25 A</p> <p>F.V tub plastmasi Ø 18-21mm</p> <p>F.V percjelles PV-500 Ø 1.5 mm2</p> <p>F.V percjelles PV-500 Ø 2.5 mm2</p> <p>F.V percjelles PV-500 Ø 4 mm2</p> <p>F.V percjelles PV-500 Ø 6 mm2</p> <p>F.V tub plastmasi Ø 22-26mm</p> <p>F.V tub plastmasi Ø 31-36mm</p> <p>F.V Çeles 1 polar 220V 10A</p> <p>F.V. Ndricues evakuimi me llampe 1x11w,IP40</p> <p>F.V priza shuko universal</p> <p>F.V kuti suport pllaket 2 mod</p> <p>F.V kuti suport pllaket 4 mod</p> <p>F.V Kutiderivacioni plastm</p> <p>F.V tub plastmasi Ø 18-21mm</p> <p>F.V. Percjelles shirit Zn 30x3mm</p> <p>F.V. Elektroda tokezimi, profil zingato e bakerizuar , L=1.5m</p> <p>F.V Panel elektrik kryesor PEK me vanocavi, mbrojtje magneto termike dhe diferenciale, me sinjalizues dhe aksesori, porte xhami sipas skemes ne vizatim sipas te gjithë standardeve</p> <p>F.V Panel elektrik kryesor PEK0 me vanocavi, mbrojtjet magneto termike dhe diferenciale, me sinjalizues dhe aksesori, porte xhami sipas skemes ne vizatim sipas te gjithë standardeve</p>	B (21- 50 milionë lekë)

		<p>F.V Panel elektrik PEK1 me vanocavi, mbrojtjet magneto termike dhe diferenciale, me sinjalizues dhe aksesori, porte xhami sipas skemes ne vizatim sipas te gjithe standardeve</p> <p>F.V Panel elektrik PEM me vanocavi, mbrojtje magneto termike dhe diferenciale, me sinjalizues dhe aksesori, porte xhami sipas skemes ne vizatim sipas te gjithe standardeve</p> <p>F.V Panel elektrik PES me vanocavi, mbrojtje magneto termike dhe diferenciale, me sinjalizues dhe aksesori, porte xhami sipas skemes ne vizatim sipas te gjithe standardeve</p> <p>F.V Panel elektrik P.E.HVAC - KASETE METALIKE IP65, mbrojtje magneto termike dhe diferenciale, me sinjalizues dhe aksesori, sipas skemes ne vizatim sipas te gjithe standardeve</p> <p>F.V Panel elektrik PE6 me vanocavi, mbrojtje magneto termike dhe diferenciale, me sinjalizues dhe aksesori, porte xhami sipas skemes ne vizatim sipas te gjithe standardeve</p> <p>F.V UPS 10kVA 3 fazore tower, me autonomi 10 min 80%</p> <p>F.V Kasete plastike KE me 72 modular (vende)</p> <p>F.V.Llampa sinjalizuese 220V 1 fazore</p> <p>F.V Shkarkues mbitemioni 3 fazore 3 polar tipit T2</p> <p>F.V. Kabell FG16OM16 3*1.5mm²</p> <p>F.V. Kabell FG16OM16 3*2.5mm²</p> <p>F.V. Kabell FG16OM16 3*4mm²</p> <p>F.V. Kabell FG16OM16 5*2.5mm²</p> <p>F.V. Kabell FG16OM16 5*4mm²</p> <p>F.V. Kabell FG16OM16 5*6mm²</p> <p>F.V. Kabell FG16OM16 5*10mm²</p> <p>F.V. Kabell FG16OM16 5*16mm²</p> <p>F.V. Kabell FG16OM16 5*25mm²</p> <p>F.V. Kabell FG16OM16 5*35mm²</p> <p>F.V. Kabell FG16OM16 1*70mm², baker</p> <p>F.V. Kabell FG16OM16 1*120mm², baker</p> <p>F.V. Kabell tokezimi verdh - jeshil 1*50mm², baker</p> <p>F.V. Kabell tokezimi verdh - jeshil 1*95mm², baker</p> <p>F.V. Tub plastmasi Ø 40 mm</p> <p>F.V. Tub PVC fleksibel serise rende Ø 63mm</p> <p>F.V.Celes elektrik 2polar 10A-250V "Gevis"devijat</p> <p>F.V. Pulsant ndricimi 10A 220V</p> <p>F.V Rele shkalle ndricimi 220V</p> <p>F.V priza shuko "Gevis" universal e kuqe</p> <p>F.V Tapa fallco</p> <p>F.V. Kuti shperndarse PT7 brenda murit</p> <p>F.V. Kuti derivacioni me kapak & vida C5-C7 jasht murit</p> <p>F.V. Kanaline Zn 100x75x3000</p> <p>F.V. Kanaline Zn 150x75x3000</p> <p>F.V. Kanaline Zn 200x75x3000</p> <p>F.V. Kanaline Zn 300x75x3000</p> <p>F.V. Kanaline Zn 400x75x3000</p> <p>F.V. Profil U 40x20x1.5 L=2m Zn</p> <p>F.V. Xhunto per kanaline 60x75 sebashku me bulonat</p> <p>F.V Aksesore per kanaline Zn 100x75 mm (Kthesa, Kryqezime, Reduktore mbylles fundore ne plan, ne ngjitje, kapak aksesoresh etj sipas rastit)</p> <p>F.V Aksesore per kanaline Zn 200x75 mm (Kthesa, Kryqezime, Reduktore mbylles fundore ne plan, ne ngjitje, kapak aksesoresh etj sipas rastit)</p> <p>F.V Aksesore per kanaline Zn 300x75 mm (Kthesa, Kryqezime, Reduktore mbylles fundore ne plan, ne ngjitje, kapak aksesoresh etj sipas rastit)</p>	
--	--	--	--

		<p>F.V Aksesore per kanaline Zn 400x75 mm (Kthesa, Kryqezime, Reduktore mbylles fundore ne plan, ne ngjitje, kapak aksesoresh etj sipas rastit)</p> <p>F.V. Upe metalike 0.8</p> <p>F.V Perzhinier fi8mm</p> <p>F.V Tub rigid 20 me te gjithë aksesoret dhe rekorderite</p> <p>F.V Tub rigid 25 me te gjithë aksesoret dhe rekorderit</p> <p>F.V Tub rigid 32 me te gjithë aksesoret dhe rekorderit</p> <p>F.V Torreto ne dysheme plastike 12 module se bashku me aksesore</p> <p>F.V Aksesore montime te ndryshem sipas rastit</p> <p>F.V Rack 42 units 200x100x80</p> <p>F.V Patch panel FTP Cate 6 S</p> <p>F.V Drejtues kabujsh LB-KDG-YKD-1UKN-BL</p> <p>F.V Suport 8 priza universale 16A 19" 1HE</p> <p>F.V Mbjatjese paisjesh 19 250 mm 2HE GR</p> <p>F.V. Kabell rrjeti, tip FTP-cat6</p> <p>F.V. Priza RJ45 cat 6</p> <p>F.V Patch corda FTP cat 6 0.5ml</p> <p>F.V Patch corda FTP cat 6 1ml</p> <p>F.V Switch I menaxhueshme 24 porta GB+ 2 SFP</p> <p>F.V Switch I menaxhueshme 24 porta GB</p> <p>F.V Router per menaxhimin e rrjetit me porte SFP dhe 8 porta GB</p> <p>F.V Sensor tymi optik i adresueshem</p> <p>F.V Sensor temperature i adresueshem</p> <p>F.V Baze per sensoret</p> <p>F.V Power supply 24VDC me bateri per Back Up</p> <p>F.V Sinjalizues per sensor tymi ne tavan</p> <p>F.V Sirene alarmi e brendshme e adresueshme, akustike+flash</p> <p>F.V Baze per sirene e brendshme</p> <p>F.V Sirene alarmi e jashtme e adresueshme, akustike+flash, IP65</p> <p>F.V Baze per sirene e jashtme</p> <p>F.V Nderfaqes adresueshem 1in/1 out</p> <p>F.V Kasa per nderfaqesuesin e adresueshem</p> <p>F.V Buton alarmi zjarri i adresueshem</p> <p>F.V Kapak per pulsantin</p> <p>F.V Central alarmi zjarri i adresueshem, me 2 loop</p> <p>F.V Bateri 12V-7Ah per centralet</p> <p>F.V. Kabell antizjarr i skermuar 1x2x1.5mm2 i kuq PH30</p> <p>F.V NVR 32 Kanale, 16 PoE,4K, 8 Sata</p> <p>F.V HDD 4 TB Sata / 64 MB WD40PURX</p> <p>F.V Kamera Dome IP 5 MP 2.8mm</p> <p>F.V Kamera Bullet IP 5 MP 2.7-13.5mm, Motorized</p> <p>F.V Bazament per kamera Bullet PFA134</p> <p>F.V Switch 24 Porta POE 370W +</p> <p>F.V.Morseta bashkuese T-I & kryq universale</p> <p>F.V.Suport plastik per mbeshetjen e shufres ne tarace</p> <p>F.V. Pusete Plastike 40x40 cm</p> <p>F.V.Shtiza me maje te zinguara d=16 mm ; L=1 ml</p> <p>F.V.Zbare ekuipotenciale Cu me nje hyrje</p> <p>70mm2+2x25mm2+4x16mm2 etj</p>	
NS 18A	Punime topogjeodezike	Punime matje volume dhe piketimi te pilotave, themeleve dhe gjithë struktures b/a etj.	A (0- 20 milionë lekë)

2.3.3 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të jenë të pajisur me licensë leshuar nga QKL, “Kodi III.2.B” (Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta), së bashku me

aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se: *“leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji”*.

Në shtojcën 1/B është listuar edhe veprimtaria “Menaxhimi i mbetjeve”.

Në nenin 57/2 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën për transportin e mbetjeve, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga ministri”*.

Ndërkohë, sipas VKM nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”: *“Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”*.

Kjo kategori licence i referohet zërave të punimeve të parashikuara në preventivin e punimeve objekt prokurimi, si “Transport dheu dhe mbeturinash me auto deri në 7 km”, etj.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi per **3 (tre) muajt** e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Kontratë pune e vlefshme;
- b) Diplomë.

Argumentimi: *Së pari*, kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Së dyti, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr.2, datë 13.05.2005 “ Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: *“drejtuesit ligjore dhe teknik te sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet*

teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohe të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” germa “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohe ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dispozitave ligjore në fuqi.

2.3.5. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, CV, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për **3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:**

- 1 (një) Arkitekt
- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Elektrik
- 1 (një) Inxhinier Mekanik
- 1 (një) Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder
- 1 (një) Inxhinier Elektronik/IT/Telekomunikacion
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “c”.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, hidroteknik, etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtues teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar si me siper, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesit Teknik të punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajftueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohe të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKB apo gjykatë. Ndalohe ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin ,stafin mbeshtetes si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

- **Arkitekt** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve sipas parashikimeve në projektin arkitektonik dhe zgjidhjet arkitektonike.
- **Inxhinieri i Ndërtimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve objekt kontrate për të gjithë zërat e punimeve ndërtimore, sipas parashikimeve në projektin konstruktiv.
- **Inxhinieri Hidroteknik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve hidroteknike lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në preventiv.
- **Inxhinieri Mekanik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve mekanike, referuar punimeve të parashikuara në preventiv.

- **Inxhinieri Elektrik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve elektrike lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në preventiv.
- **Inxhinieri Elektronik/IT/Telekomunikacion** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve elektronike.
- **Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve që përfshin kuota dhe piketime lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në preventiv.
- **Inxhinier Mjedisi** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve mjedisore me zërat e punimeve të parashikuara në preventiv.

2.3.6 Një punësim minimalisht prej **65** (gjashtëdhjetë e pesë) punonjës, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për **3 muajt** e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për **3 muajt** e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- b. Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për **3 muajt** e fundit të deklaruar.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje tre mujore nga data e zhvillimit të tenderit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. *Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.* Vendorsja e kriterit për një punësim të paktën 65 punonjës duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën e punimeve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet

teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në mënyrë të përmbledhur numri i fuqisë puntorë që kërkohet për realizimin e punimeve është min **65 punonjes**

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/ certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

Teknik Ndertimi	1
Hidroizolues	3
Suvatues	3
Punonjes gipsi	3
Punonjes fasade	3
Karpentier	6
Hekurkthyes	5
Pllakashtrues	3
Bojaxhi	2
Elektracist	4
Hidraulik	3
Instalues dhe riparues të sistemeve ngrohje-ftohje	3
Punonjes skelerie	3
Shofere/Manovratore	3

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

2.3.7/1 Për punonjesit manovrator/shofer, ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) kontratë individuale të punës;
- b) leje drejtimi, certifikate e aftësisë profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR. (Në rastin kur punonjësit Manovrator/shofere janë të kontraktuar me kontratë punë (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Për punonjësit me profesionet si më sipër (sipas pikës 2.3.7), operatorët ekonomik ofertues duhet të plotësojnë tabelën me të dhënat si më poshtë :

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1				
2				
etj				

Argumentimi: *Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”. Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të percaktuara në specifikimet teknike. Zbatimi i punimeve që përfshijn projektin duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/ certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”. Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të regjistruara në “rregjistrat profesionale” të AKAFP-se. Percaktimi i numrit të punonjesve dhe profesionet është bazuar mbi zërat dhe volumet e punes si dhe afateve për perfundimin e punimeve, në mbështetje të Manualit të ndërtimit miratuar me Vendim nr.629, date 15.07.2015 (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar në kriter elementet e strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport). Numri i punonjesve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.*

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Tekniku i ndërtimit** është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Pllakashtrues** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të shtrimin dhe veshjen e pllakave, sipas zërave të preventivit të punimeve.

- **Suvatues** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të suvatimit, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Shoferë/Manovratorë**, janë te nevojshem per drejtimin manovrimin e mjeteve të rënda.
- **Hidroizolues** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të termo-izolimit me materialin e duhur sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Punonjes gipsi** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të gipsit, sipas zërave të preventivit te punimeve.
- **Punonjes per fasaden**, është i nevojshëm për realizimin e punimeve të fasades qe perfshin sistemin kapot dhe punime alukobondi, sipas zërave të preventivit te punimeve.
- **Bojaxhiu**, është i nevojshëm për realizimin e punimeve të lyerjes, sipas zërave të preventivit.
- **Karpiertier**, është i nevojshëm për prerjen dhe montimin e strukturave prej druri si dhe ndërtimin e kornizave dhe strukturave të tjera përforcuese prej druri apo materiale të tjera, të nevojshme për realizimin e zërave të punës sipas preventivit të punimeve.
- **Hekurkthyesi** është i nevojshem për realizimin e punimeve të hekurit, referuar zërave të preventivit të punimeve.
- **Hidrauliku** është i nevojshem për ndjekjen dhe realizimin e punimeve hidraulike, sipas zërave të preventivit të punimeve
- **Elektracisti** është i nevojshem për ndjekjen dhe realizimin e punimeve elektrike, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Instalues dhe riparues të kondicionerëve dhe sistemeve ftohëse-ngrohëse** është i nevojshem për ndjekjen dhe realizimin e punimeve të kondicionimit dhe aspirimit, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Punonjes skelerie** eshte i nevojshem per montimin e skelerise te cilat do te perdoren per te gjitha punimet e fasadave.

2.3.8 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/çertifikuar si:
1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “*Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave*” e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- Diplomë/certifikatë
- Kontratë Pune të vlefshme

Shënim: *Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.*

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

2.3.9 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre 1 (një) punonjës me çertifikatë “*Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë*” në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr.

10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Për të dëshmuar përbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- Diplomë/certifikatë
- Kontratë Pune të vlefshme

Shënim: *Kjo kërkesë përbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.*

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Autoriteti Kontraktor argumenton se kërkesa për *Përgjegjësin për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë* si dhe për *Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave* është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "c", si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, "*Për sigurinë dhe shëndetin në punë*", sipas të cilit: „*Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....*“.

Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësit e kërkuar, nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

"Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave" rekomandohet te jete ne kantier ne rast aksidentesh ne pune

Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" rekomandohet te jete ne kantier per minizimin e aksidenteve ne pune.

2.3.10 Deklaratë e ofruesit për modelin, kompaninë prodhuese, për mallrat e paisjet që do të vendosen në objekt sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Emërtimi i pajisjes	Modeli	Kompania prodhuese, Web, E-mail, Nr. kontakti
370	F.Pompa e furnizimit me uje sanitar; Grup i furnizimit me uje sanitar me 2 pompa Vertikale me Shume shkalle me motor On/Off, te lidhura ne paralel; me panel komandimi dhe presostate per 2 pompa per funksionim automatik. Prurja= 10.0 m ³ /h (per secilen pompe); H =50 m; 3x400V;P= 2 x 4 kw; Lidhjet: 2";		
374	F. POMPA E IMPIANTIT TE MBROJTJES NGA ZJARRIT - SISTEMI I MNZ-se; Grupi i MNZ sipas EN12845 i perbere nga 2 Pompa njera Elektrike dhe tjetra Diesel 2x15kw (1 ne pune + 1 ne stand-by) ku secila jep Q= 40 m ³ /h; H=60 mkH ₂ O; Pompe Pilot "Jockey" 1x0,65 kË, Grupi i MNZ kompletuar me Kit Testimi me matesFuqia elektrike /tensioni ushqimi:26.2 kw 400V/3 F~ 50 Hz Pesha = 700 kg me permasa AxBxC; (2x940) x 1340 x 1740 mm. Gazi ftohes R 410 A”		
391	F. NJESI E JASHTEME KOMPRESOR INVERTER ME POMPE NXEHTESIE VRF PER KATIN +1 dhe -1 °; Kapaciteti ftohes / ngrohes ne temperaturen -1/36°C :84 / 94.5 kw; Fuqia elektrike / tensioni /ushqimi : 26.2 kw, 400V / 3 F ~ 50Hz . Pesha = 700 kg, me permasa AxBxC: (2x940) x 1340 x 1740 mm.Gazi ftohes R410A		

392	F. NJESI E JASHTEME KOMPRESOR INVERTER ME POMPE NXEHTESIE VRF PER KATIN 0° Kapaciteti ftohes / ngrohes ne temperaturen -1/36°C :123 / 138 kË . Fuqia elektrike / tensioni /ushqimi : 38 kw, 400V / 3 F ~ 50Hz . Pesha = 800 kg, me permasa AxBxC: (2x940) x 1340 x 1740 mm.Gazi ftohes R410A		
393	F. NJESI E JASHTEME KOMPRESOR INVERTER ME POMPE NXEHTESIE VRF PER RIKUPERATORET E AJRIT Kapaciteti ftohes / ngrohes ne temperaturen - 1/36°C :56 / 63 kw . Fuqia elektrike / tensioni /ushqimi : 16.2 kw, 400V / 3 F ~ 50Hz . Pesha = 400 kg, me permasa AxBxC: (2x765) x 1340 x 1740 mm.Gazi ftohes R410A		
394	F. NJESI RIKUPERATORE AJRI; Volumi i ajrit. 3920 m ³ /h ; Presioni statik i jashtem 200 Pa; Fel.ventilatoreve 2x0.9 kw 1F~230V,50Hz; Kap.Termik ne Ngrohje 40 kw ;Kap.Rekuperimi Ngrohje 57%; Kap.Rekuperimi Ftohje 50% Dimensionet A,B,C: 600×235×2050 mm; Pesha 400 kg		
407	Ashensore (3 ndalesa/ dyer inoxi/ kabina inox forest, kendet inoxi) 630 kg Kapaciteti 8 Persona.		

- Tabela është e detyrueshme për tu plotësuar për të gjithë artikujt e listuar. Mosplotësimi i kësaj tabele është kusht skualifikues.

2.3.10/a Për pajisjet e tabelës së dhënë në pikën 2.3.10, Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, me të cilin prodhuesi ose distributori i autorizuar, autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje. Në rast paraqitje autorizimi distributori autorizuar, duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet kryesore të kerkuara.

2.3.10/b Të paraqiten katalogët nga prodhuesi/prodhuesit apo distributorit të autorizuar nga prodhuesi, për të gjitha pajisjet sipas pikës 2.3.10. Në katalogë, duhet të markohet me ngjyrë të qartë pajisja që ofrohet dhe të pasqyrohen specifikimet teknike të kërkuara për këto pajisje.

Fleta ose fletët e katalogut që pasqyrojnë specifikimet teknike të kërkuara të pajisjes, duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, të përkthyer dhe noterizuar.

2.3.11 OE të paraqesë një deklaratë, ku merr përsipër të garantojë instalimin si dhe servisin e pajisjeve gjatë periudhës së garancisë (2 vite), për defektet që vijnë nga prodhimi i tyre

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, nenin 39, pika 8, si dhe në bazë të nenit 45, pika 1 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Në preventivin e punimeve ka një numër të madh zërash që janë furnizim vendosje pajisje dhe nisur nga pesha specifike si në sasi dhe në vlerë që këto zëra zënë në preventive. AK e ka parë të domosdoshme kërkimin e autorizimit të prodhuesit për të garantuar cilësinë e pajisjeve për nga vetë rëndësia që ka ky objekt. Kërkesa e këtij dokumenti që në këtë fazë krijon një lehtësi për Autoritetin Kontraktor pasi në këtë mënyrë siguron cilësinë, specifikimet teknike të këtyre pajisjeve e cila është lehtësisht e kontrollueshme gjatë fazës së zbatimit në referencë me dokumentat e paraqitura që gjatë kualifikimit. Nepermjet dorëzimit të këtij dokumentacioni që në fazën e vlerësimit asnjë OE ekonomik nuk i shmanget dot detyrimit që gjatë zbatimit të furnizimit të njejtin mall të certifikuar nga KVO.

Kjo kërkesë është kërkuar që t'i sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshëm teknik dhe plotëson specifikimet e kerkuara nga projektuesit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontratave, njësisia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/ distributor autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë pajisjet dhe mallrat e nevojshme në këtë procedurë prokurimi. Duke qenë se materialet e kerkuara prodhohen në mënyrë industriale, certifikimi nga prodhuesi mbi parametrat e tyre është i domosdoshëm.

Duke marrë shkas nga tipologjia e objektit të prokurimit dhe nga punimet/shërbimet që parashikohen të realizohen në preventive si dhe për shkak të interesit të lartë që ka objekti duhet të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane, është gjykuar të domosdoshme të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane, që OE ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën, duke furnizuar

brenda kohës së përcaktuar vetëm pajisje origjinale me garanci, si dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të bërë krahasueshmërinë e materialeve të ofruara nga operatori me ato të kërkuara në dokumentat e tenderit. Për të siguruar këtë gjë, por njëkohesisht dhe për të detyruar ofertuesit e mundshëm në zbatimin e këtyre standarteve ka parashikuar kërkesen e mësipërme, vetëm për disa nga mallrat kryesorë me që do të përdoren në këtë objekt dhe konkretisht OE duhet të japin dhe paraqesin në menyrë të detajuar karakteristikat teknike të mallrave të përfshirë në dokumentat e tenderit, karakteristika këto që duhet të përputhen me specifikimet teknike të kërkuara nga projektuesi. Me anë të venies në dispozicion në fazën e ofertimit dokumentat si autorizim-marreveshje angazhimi, kataloge, ofertuesi garanton Autoritetin Kontraktor se mallrat që do të furnizojë do të jenë prodhim sipas kërkesave të projektit. Plotësimi i kërkesës me siper garanton Autoritetin Kontraktor për cilësinë dhe standartet e larta ndërkombëtare dhe të përditësuara sipas teknologjisë së re dhe bashkëkohore.

2.3.12.Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- a) Certifikatën e cilësisë së punimeve **ISO 9001-2015** (e vlefshme)/ose/ekuivalent. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- b) Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit **ISO 14001-2015** (e vlefshme). /ose/ ekuivalent. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- c) Certifikatën **ISO 45001:2018** (Mbi Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë) ose ekuivalent. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- d) Çertifikatën e menaxhimit të energjisë **ISO 50001-2018**/ekuivalente (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Certifikatat si më sipër duhet të paraqiten origjinale ose kopje të noterizuara, të leshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.12 gërma “a”- “d” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të leshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i

akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtarë, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

ISO 50001-2018 është një standard i ri i konceptuar për të asistuar kompanitë në zbatimin e një sistemi të menaxhimit të përshtatshëm për identifikimin dhe minimizimin e konsumit energjetik. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 50001:2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi), të reduktojë kostot energjetike të kompanive, emisionet e gazrave serë (GHG) dhe impaktet e tjera në mjedis. Në Preventivin e punimeve parashikohen zëra elektrik, ku zbatimi i tyre kërkon që Ofertuesi të jetë i pajisur me Certifikatë ISO 50001-2018.

Në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, cilësohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”.

Për sa më lart, Njësia e Prokurimit, gjykon se, kjo kërkesë në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik duhet të përmbushet nga Shoqëria e cila referuar Marrëveshjes së Bashkëpunimit ka marrë përsipër të realizojë zerat elektrike të parashikuara sipas Preventivit.

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara sipas pikës 2.3.12, gërma “a”- “d”, është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

2.3.13. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi/cope	Statusi
1	Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 10 ton	copë	3	Në pronësi ose me qera
2	Kamion vetshkarkues me kapacitet 3-5 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
3	Eskavator me goma	copë	1	Në pronësi ose me qera
4	Eskavator me zinxhir	copë	1	Në pronësi ose me qera
5	Rrul (Kompresor) me vibrim	copë	1	Në pronësi ose me qera
6	Autobitumatrice	copë	1	Në pronësi ose me qera
7	Vinc	copë	1	Në pronësi ose me qera
8	Autovinc	copë	1	Në pronësi ose me qera
9	Sondë për realizimin e pilotave	copë	1	Në pronësi ose me qera
10	Gjenerator	copë	1	Në pronësi ose me qera
11	Depozite uji deri ne 5000 litra	copë	1	Në pronësi ose me qera
12	Pompe Suvatimi	copë	1	Në pronësi ose me qera
13	Makineri per prerje hekur ndertimi	copë	1	Në pronësi ose me qera
14	Makineri per kthim hekur ndertimi	copë	1	Në pronësi ose me qera
15	Elektrosaldatrice	copë	1	Në pronësi ose me qera
16	Elektroorgano	copë	1	Në pronësi ose me qera
17	Vibrator	copë	2	Në pronësi ose me qera
18	Betoniere 500 lit	copë	1	Në pronësi ose me qera
19	Paisje niveluese për nivelim shtresash	copë	1	Në pronësi ose me qera
20	Pompë uji	copë	1	Në pronësi ose me qera
21	Skela	m2	750 m2 (min)	Në pronësi ose me qera

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit Nr. 8 të DST.

- a. Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit: (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti (i vlefshëm);
- b. Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse e Qerasë/huapërdorjes e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm);
Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.
- c. Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Mjetet dhe pajisjet e kërkuara janë vendosur në proporcion me zërat dhe volumet e punimeve dhe afatin e përlllogaritur për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i’u referuar punimeve sipas standardeve, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

1. Kamion me kapacitet mbi 10 ton. Prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit.
2. Kamion me kapacitet 3-5 ton prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit dhe për transportin e materialeve të ndryshme të ndërtimit, hidraulike elektrike etj ku mjeti është i favorshen pasi mund të qarkullojë në territor pa orar .
3. Eskavator me goma prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit dhe zërin Germim dheu.
4. Eskavator me zinxhir prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit dhe zërin Germim dheu.
5. Rul (Kompresor) me vibrim prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit dhe zërin në preventiv
6. Autobitumatrice prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit dhe zërin në preventiv
7. Vinc prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit konkretisht për ngritjen e materialeve në lartësi .
8. Autovinc prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit konkretisht për ngritjen e materialeve, paisjeve të ndryshme, montim të materialeve të tjera në lartësi.
9. Sondë për realizimin e pilotave në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses.
10. Gjenerator- prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo pajisje është e domosdoshme për sigurimin e energjisë elektrike në rastet e mungesës së saj.
11. Depozite uji (kapaciteti minimal 5000 litra) prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit konkretisht për punimet e betonit, suvatimit, etj.
12. Pompë suvatimi- prezenca e tyre në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit konkretisht për punimet e suvatimit.
13. Makineri për prerje hekur ndërtimi – nisur nga fakti që në zerrat e preventivat janë parashikuar punime hekuri ndërtimi.
14. Makineri për kthim hekur ndërtimi– nisur nga fakti që në zerrat e preventivat janë parashikuar punime ndërtimi kthim hekuri .
15. Elektrosaldatrice – nisur nga fakti që në zerrat e preventivat janë parashikuar punime ndërtimi kthim hekuri .

16. Elektroorgano- nisur nga fakti qe ne zerat e preventivat jane parashikuar punime ndërtimi për rafinimin e metaleve
17. Vibrator prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit.
18. Betoniere me kapacitet mbi 0.5 m3 - prezenca e tyre në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit, pergatitjen e sasive te vogla te betonit.
19. Paisje niveluese për nivelim shtresash -prezenca e tyre në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit, per zerat qe kane punime shtresash etj.
20. Pompë uji- prezenca e tyre në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit.
21. Skela metalike -prezenca e tyre në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit, per realizimin e te gjitha punimeve te fasades dhe ne lartesi..

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim:

Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të plotësojnë formularin e ofertës, sipas kërkesave të përcaktuara në shtojcën 1, pjesë e këtyre dokumenteve të tenderit.

Gjithashtu Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të plotësojnë edhe preventivin e punimeve i cili është vënë në dispozicion nga autoriteti kontraktor, pjesë e këtyre dokumenteve të tenderit.

Kandidati, ofertuesi i huaj duhet të vërtetojë se plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër. Operatorët e huaj ekonomikë duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën shqipe, të bëjnë noterizimet përkatëse si dhe t'i certifikojnë me vulën "Apostille". Për vendet që nuk e kanë ratifikuar Konventën e Hagës, datë 05.10.1961 për "Heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumentave zyrtare të huaj", duhet të bëhen legalizimet e këtyre dokumentave në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës. Mosparaqitja e dokumentacionit në këtë formë është kusht s'kualifikues.

Në rastin e moslëshimit në vendin e origjinës të dokumentave të kërkuara sipas kriterëve të mësipërme, ofertuesi duhet të vërtetojë ligjërisht moslëshimin e tyre nga institucione përkatëse të vendit të origjinës.

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (e ndryshuar), ku parashikohet: "Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të

vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, sjellim ne vemendje se:

- Dokumentet perkatese vertetuese per disponimin e punonjësve do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

- Autoriteti/enti kontraktor perpara publikimit te njoftimit te fitesit do t'i kërkojë ofertuesit te kualifikuar nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të paraqitura ne sistemin elektronik të prokurimit gjate fazës së ofertimit. Mosparaqitja e dokumentacionit të sipërcituar do te jete kusht s'kualifikimi.

- Autoriteti Kontraktor do te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimet e bera në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht s'kualifikimi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Argumentimi i specifikimeve teknike :

Janë sipas të dhënave dhe shënimeve teknike në projektet e zbatimit, bashkëlidhur DST-ve, të dërguara pranë organit qendror blerës nga Autoriteti Kontraktor përfitues (Agjencia Kombetare e Punesimit dhe Aftesive) dhe të hartuara nga projektuesi.